



MEKANIZMI KOORDINUES PËR VENDIN (MKV), SHQIPËRI

Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Njësisë së Menaxhimit të Projektit (PMU) fton të gjithë organizatat jo-fitimprurëse (OJF), institucionet qeveritare, akademike, shoqatat e personave që jetojnë ose janë të afektuar nga HIV/AIDS-i dhe TB-ja, organizatat ndërkombëtare të shfaqin

paraprake dhe të dëshmojnë se organizata ka qenë aktive minimalisht në 5 vitet e fundit në zbatim të projekteve në fushën e shëndetësisë dhe/ose atë të mbrojtjes sociale;
Kriteret për vlerësimin e propozimeve të dorëzuara
Organizatat të cilat do të përjashtohen

QERSHOR, 2018

Fondacionet apo shoqatat që janë të pezulluara me urdhër të gjykatës; Organizatat kanë kontrata të pezulluara nga donatorë; Janë organizatat fitimprurëse.

Në brendësi do të lexoni:

Takimi Ministror i HIV për Evropën Juglindore, në Shkup më 7 maj 2018.

Shtyhet thirrja për aplikime për Nën/ Përfitues të Fondit Global

interesin e tyre për paraqitjen e projekt-propozimeve për zbatimin e aktiviteteve të grantit sipas termave të referencës të publikuara në faqen e internetit të MSHMS dhe të MKV-s.

Organizatat e interesuara duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për realizimin e këtyre aktiviteteve. Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi në Zyrën e Protokollit, dhe e-mail) deri në datë 20.03.2018, ora 16:30.

Kriteret për përzgjedhjen e organizatave nën-marrëse

1. Kriteret për pranim në procesin e përzgjedhjes

Kërkesat/kushtet minimale për pranimin e propozimeve do të jenë: Forma e shprehjes së interesit; Paraqitja e dokumentacionit; Përveç kësaj organizatat që konkurrojnë duhet të jenë: Organizata të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi; Të kenë përvojë

nga përzgjedhja automatikisht janë si vijon: Janë dënuar me vendim të formës së prerë për një ose më shumë nga akuzat e mëposhtme: pjesëmarrje në organizatat kriminale, korrupsion, mashtrim, pastrim parash; Janë në situatë falimentimi, likuidimi, përfundim aktiviteti, janë në gjendje të falimentimit, likuidimit, ndërprerjes së veprimtarisë, falimentimit ose marrëveshjes me donatorët/kreditorët ose ndonjë situatë të ngjashme që lind nga një procedurë e të njëjtit lloj ose që i nënshtrohen një procedurë të të njëjtit lloj; kanë marrë një gjykim me fuqi res judicata, për një vepër penale që ndikon në integritetin e tyre profesional ose përbën një sjellje të pahijshme profesionale; nuk janë në përputhje me detyrimet e tyre në lidhje me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, tatimet dhe detyrimet, sipas dispozitave ligjore në fuqi; Fondacionet apo shoqatat që janë të anëtarësuara apo bashkëveprojnë si parti politike;


Faqe 6



RAPORTI FINAL

Mbledhja e menaxherëve të programit të TB-s; 31 Maj-2 Qershor 2017

Faqe 7





Komisioni i Vlerësimit, rezervon të drejtën të kërkojë nga aplikantët që të ofrojnë dokumentet mbështetëse që tregojnë se kërkesat e paraqitura janë plotësuar.

Komisioni refuzon çdo aplikim nga organizata, kur konstaton se janë në kushtet e konfliktit të interesit në përputhje me Ligjin Nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike".

Vlerësimi i organizatave do të bëhet duke kaluar 2 (dy) faza:

➤ Faza e I:

Vlerësimi administrativ

Dokumentacioni dorëzuar në afat;

Dokumentacioni dorëzuar: 1 origjinal (sipas rastit) dhe 2 kopje; CV e organizatës dhe lista e projekteve të realizuara 5 (pesë) vitet e fundit;

CV e stafit që do punojë/përfshihet në projekt; Vendimi i gjykatës (kopje);

Statuti i organizatës (kopje);

Bilani financiar i vitit të fundit (2017);

Vërtetim i llogarisë bankare.

Dokumentacioni i pakompletuar dhe mosdorëzimi i dokumentacionit në kohë (sipas shpalljes së publikuar), prezantimi i të dhënave jo të sakta, nuk i kualifikon organizatat për të kaluar në faen tjetër – në Fazë e dytë : Vlerësimi Teknik;

➤ Faza e II:

Vlerësimi Teknik

Kriteret e vlerësimit dhe pikëzimi për çdo kriter:

Rëndësia, përputhja e projektit me strategjinë kombëtare të HIV/AIDS, strategjitë rajonale/lokale: **5 pikë**;

Sinergji, inovacion, vazhdimësia, me projekteve të tjera të ngjashme: **5 pikë**;

Përshkrim i situatës, problematikës të popullatës së synuar/targetuar: **10 pikë**

Përshkrimi i ndërhyrjeve: **10 pikë**

Ndërhyrje të mëparshme: **10 pikë**;

Ekspertiza /kapaciteti i organizatës: **20 pikë**;

Përvoja dhe CV e stafit që do punojë/do përfshihet në projekt : **20 pikë**

Qëndrueshmëria e projektit, vijueshmëria e aktiviteteve dhe organizatës: **20 pikë**;

Pranimi dhe vlerësimi i ankesave: **3 ditë**

Shpallja e fituesve: Organizatat të cilat i kanë dërguar propozimet do të njoftohen për rezultatet e vlerësimit 3 (tre) ditë pas marrjes së vendimit dhe shqyrtimit të ankesave; Cilido nga aplikantët i që nuk kualifikohet ka të drejtë në ankesë

Informacione më të detajuara i gjeni në faqet eeb të përshkruara më poshtë si edhe të botuara në shtypin periodik.

www.shendetesia.gov.al

www.ccm-albania.al

e-mail

:info@shendetesia.gov.al

Shpallet thirrja publike për OSHC-t për pjesëmarrje në dialogun e hapur rajonal për zhvillimin e aplikimit shumë-vendor në Fondin Global

Mekanizmi Rajonal i Bashkërendimit të Evropës Juglindore (SEE RCM) shpall një thirrje publike për organizatat e komunitetit të popullatave kyçe për të marrë pjesë në një dialog të hapur rajonal për zhvillimin e aplikimit shumë-vendor në Fondin Global për luftimin e HIV, Tuberkulozit dhe Malariaes që do të ndodh gjatë SEE RCM dhe u mbajt më 26-27 shkurt 2018 në Shkup, Maqedoni. Organizata të komunitetit që përfaqësojnë popullatat kyçe që vijnë nga rajoni i Evropës Juglindore (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Moldavia, Rumania, Serbia) dhe punojnë në çështjet e HIV-it: 1.Njerëzit që jetojnë

me HIV; 2.Meshkujt që kryejnë seks me meshkuj; 3. Punonjëset e seksit; 4. Përdoruesit e drogës dhe 5. Komunitetet Transgjnore u ftuan të jenë pjesë e ktij dialogu rajonal. Organizatat e komunitetit duhet të jenë të përbëra dhe të udhëhiqen nga popllata kryesore dhe jo të jenë përfaqëues të shoqërisë civile që punojnë me popullatat kyçe. Organizatat e komunitetit u ftuan të dorëzonin kërkesat e tyre pranë Sekretariatit të MKR-s (RCM të SEE), në adresën e e-mail-it: ana.filipovska@nkm.mk duke paraqitur si në vijim: Historikun e organizatës së komunitetit, cilat komunitete të popullatave kyçe përfaqësojnë; veprimtarinë e tyre në fushën e parandalimit të HIV-it dhe shprehjen e interest për të marrë pjesë në dialogun rajonal për zhvillimin e një aplikimi shumë-vendesh në Fondin Global.

Dokumentat me shkrim duhet të dorëzoheshin së bashku me një përshkrim të shkurtër zyrtar të aplikimit deri më 16 shkurt 2018 deri në ora 16:00 CET në e-mailin e mësipërm. Dy ditët e fundit pas afatit të dorëzimit do të njoftohen nëse organizatat e shoqërisë civile janë zgjedhur për të marrë pjesë në takimin e tretë të MKR (RCM) dhe në dialogun e hapur rajonal për Europën Juglindore për zhvillimin e një aplikimi me shumë vende në Fondin Global për luftën ndaj HIV, Tuberkulozit dhe Malariaes.

Propozimi do të paraqes katër nën-fusha programatike që do të adresoheshin nga grantet multikombëtare me qëllimin e përgjithshëm të përsheptimit dhe

përparimit deri në vitin 2020 duke siguruar qëndrueshmërinë e shërbimeve të HIV-it për popullatat kyçe. Këto nën-fusha do të jenë: 1) Financim i qëndrueshëm për shërbimet e HIV për popullatat kyçe, 2) Qasje e qëndrueshme në barnat ARV dhe pajisje të tjera mjekësore cilësore në parandalimin e HIV, 3) Reduktimin e stigmës dhe diskriminimit të popullatave kyçe dhe 4) Përmirësimi i efikasitetit të modeleve të ofrimit të shërbimeve të HIV për popullatat kyçe. Qëllimi gjeografik i Propozimit të MKR do të përfshijë zgjerimin në vendet e Evropës Lindore dhe Azinë Qendrore (EECA). Propozimi do të jetë në përputhje me dokumentacionin e kërkuar për një zhvillim të qëndrueshëm financimi në shërbimet e HIV-it për popullatat kyçe me përfshirjen e disa elementeve të nën-zonave të tjera të fokusit.



Projekt-Propozimi i dërguar do të ketë mbështetje në këto pika të forta:

Maksimizimin e ndikimit ndaj HIV ndaj përfundimit të epidemive; Propozimi do të paraqes një analizë të mirë të mangësive dhe bën një analizë racionale mbi nevojën për mbështetjen me financime; Fushat e përzgjedhura për ndërhyrje do të bazohen në të dhënat epidemiologjike, ligjore / politike dhe financiare. Propozimi do të trajtojë mangësitë në të dhënat epidemiologjike për popullatat kyçe, magësitë e qeverive të vendeve të rajonit për të financuar ofrimin e shërbimeve të HIV-it tek popullatat kyçe dhe modelet e pamjaftueshme të ofrimit të shërbimeve për këto target-grupe. Propozimi do të ofrojë një përshkrim të mirë të sinergjive me grantet e tjera kombëtare të programit dhe procesin e zbatimit të tij për të përfshirë qeveritë dhe komunitetet rajonale. Treguesit do të jenë të dizajnuara mirë për të matur arritjen e suksesshme të objektivave.

Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe barazia gjinore; Mekanizmat e koordinimit rajonal dhe të mbikëqyrjes të krijuara në kuadër të Fondit Global për rajonin, veçanërisht Komiteti Teknik Konsultativ do të jenë të hartuara mirë dhe do të ndihmojnë për angazhimin e anëtarëve të popullatave kyçe dhe organizatave të shoqërisë civile në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e projektit, duke siguruar koordinim me anëtarët dhe qeveritë e Rajonit të përfshira në MKR; Do të investohet në rritjen e cilësisë së programit dhe efikasitetit të zbatimit të programeve përmes pronësisë së përbashkët dhe llogaridhënies reciproke; Përbërja e MKR, që përfshin zyrtarë qeveritarë nga disa vende dhe anëtarë të shoqërisë civile, i jep projektit një mundësi më të madhe për koordinim rajonal dhe përdorimin e të gjithë levave; Aplikuesi i propozuar si implementues ka shërbyer si nën-përfitues në grantet e mëparshme të Fondit Global dhe ka treguar qëndrueshmëri në performancën e suksesshme në të kaluarën; Aplikuesi do të propozojë të mbështetet në progresin e bërë deri më sot në mbështetjen e shërbimeve për popullatat kryesore në Kosovë, Bullgari, Maqedoni dhe Mal të Zi.

vendeve të Fondit Global për Propozime - HIV: Qëndrueshmëria e Shërbimeve për Popullsitë Kryesore në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore. Tetë vendet e Evropës Juglindore që po kalojnë nga mbështetja e Fondit Global në burimet kombëtare të financimit (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Rumania dhe Serbia) mirëpresin Moldavinë në MKR. Nga Shqipëria në këtë takim rajonal morën pjesë dy përfaqësueset një nga institucionet shtetërore dhe një nga shoqëria civile, Përfaqësimi në MKR u bë me votim në Mbledhjen e MKV-s Shqipëri të datës 26 Janar 2018, pas ftesës zyrtare nga MKR për përzgjedhjen e përfaqësimit të Shqipërisë për këtë meknizëm rajonal. Dy përfaqësueset e Shqipërisë në këtë mekanizëm rajonal janë Znj. Merita Xhafaj, Drejtoresha e Politikave në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si edhe Znj. Olimbi Hoxhaj si përfaqësuese e Shoqatës së Përonave që Jetojnë me HIV/AIDS në Shqipëri. Pjesëmarrësit e takimit u pritën nga Dr Venko Filipče, Ministri i Shëndetësisë i Maqedonisë dhe Aida Kurtović, kryesuese e Bordit të Fondit Global.

Mbahet takimi i MKR të Europës Juglindore më 26-27 Shkurt 2018 në Shkup, Maqedoni

Mekanizmi Koordinues Rajonal i Evropës Juglindore (RCM) më 27 shkurt 2018 mbajti takimin e tretë në Shkup, Maqedoni. Qëllimi i takimit ishte të binte dakord mbi elementet e projektit për Kërkesën për Grante të shumë



Për të siguruar konsultime domethënëse brenda popullatave kyçe, përfaqësuesit e organizatave të komunitetit që vijnë nga popullata kyçe që MKR do të donte të mbulonte në projekt-propozim u ftuan në një takim konsultativ një ditë përpara takimit të MKR. Objektivat specifike të këtij takimi ishin:

1. Identifikimi i prioriteteve kryesore të avokimit rajonal për vitin 2018 për rritjen e fondeve vendase drejt qëndrueshmërisë së programeve të HIV dhe Tuberkulozit.

2. Rishikimi i disponueshmërisë, burimeve dhe nevojave, duke përfshirë mundësitë për iniciativa të financuara nga donatorët.

3. Hartimi i një plan avokimi rajonal, për finalizimin e mëtejshëm dhe miratimin nga MKR-ja.

MKR-ja hapi diskutim nëse organizatat dhe rrejetet e komunitetit do të merrnin përsipër disa nga aktivitetet e projektit të propozuar për Fondin Global.

MKR do të kryejë avokim bashkëpunues dhe shkëmbim të përvojave në rajon për t'u adresuar si në vijim: 1. Prioritizimi i qëndrueshmërisë dhe tranzicioni i përgjegjshëm i zbatuar në vendet e Evropës Juglindore, veçanërisht për parandalimin, diagnostikimin, trajtimin, kujdesin dhe mbështetjen.



Shërbimet midis popullatave kryesore, të cilat shpesh janë të rrezikuara pas përfundimit të Fondit Global dhe pasi donatorët të tjerë pushojnë financimin në këto vende; 2. Forcimi i vizionit për ngritjen e programeve në përputhje me strategjitë teknike dhe deklaratat politike globale dhe rajonale veçanërisht në adresimin e zhvillimeve të epidemisë për popullata kryesore dhe atovulnerabël. Për këtë qëllim MKR-ja adreson se popullatat kryesore dhe të prekshme përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në: Personat që përdorin

drogë; Punonjësit e seksit, të të gjitha gjinive dhe identiteteve gjinore; Meshkujt që kanë marrëdhënie seksuale me meshkuj; Personat transgjitorë; Personat në ambiente të mbyllura, duke përfshirë burgjet, dhe ato të paraburgimit; Popullatat e lëvizshme; Popullatat Rome; Rinia nën rrezik të shtuar; Personat që jetojnë me ose preken nga sëmundjet e fokusit. 3. Zgjerimi dhe integrimi i HIV, TB dhe shërbimeve të tjera të lidhura me to në sistemet për shëndetin, brenda konceptit të mbulimit të shëndetit universal. 4. Mbrojtja e të drejtave të njeriut si një parim udhërrëfyes për të gjithë hartimin dhe ofrimin e shërbimit, duke vazhduar përpjekjet për të forcuar zbatimin e tyre. Heqja e ligjeve ndëshkuese dhe barrierat e tjera shoqërore, dhe luftimi i stigmës dhe diskriminimit duhet të ketë rëndësinë dhe fokusin e duhur. 5. Mbështetja e vendeve të rajonit për të kuptuar më mirë epidemitë e tyre, nëpërmjet përmirësimit të cilësisë dhe analizën e të dhënave, si dhe tendencat rajonale dhe nevojën për bashkëpunim ndërkufitar.

Arocha Specialist i Qëndrueshmërisë, Tranzicionit dhe Bashkëfinancimit pranë Fondit Global.



Ekipi i Fondit Global zhvilloi disa takime të rëndësishme me institucione shtetërore, shoqata dhe grupe interesi, me stafin e Njësisë së Zbatimit të Projektit, si dhe me titullarë të Ministrisë së Shëndetësisë. Në fokus të këtyre takimeve ishte:

➤ Procesi i fazës përgatitore të dokumentacionit të Projektit si dhe ai i ngritjes së Njësisë së Zbatimit të Projektit të Grantit të Fondit Global për HIV/TB në Shqipëri.

➤ Do të bëhet një vlerësim mbi ecurinë e zbatimit të granteve, do të identifikohen sfidat dhe njëkohësisht do të hartohen dhe merren masat për ndërveprimet korrigjuese.

Vizita e Portofol Menaxheres dhe grupit të ekspertëve teknikë të Fondit Global në Shqipëri

Menaxherja e Fondit Global për Shqipërinë Znj. Sandra Irbe, zhvilloi një vizitë pune në Tiranë në datat 30 Prill deri në 4 Maj 2018 në kuadrin e përgatitjeve të fillimit të procesit të zbatimit të Projektit Kombëtar të HIV/TB-n. Gjatë tre ditëve të vizitës së saj në Tiranë, Zj. Sandra Irbe, u shoqërua edhe nga Znj. Ganna Bolokhovets, Specialiste për Menaxhimin e Produkteve të Shëndetit dhe Z. Oscar

Gjatë vizitës gjithashtu u bë një vlerësim mbi progresin në zbatimin e rekomandimeve nga vlerësimet e LFA-s, që lidhen me masat e ndjekjes së planit të punës të përfshira në Kornizën e Performancës së Konfirmimit të Grantit.

➤ Një pikë e rëndësishme e vizitës ishte edhe përgatitja e dhe hartimi i çështjeve për Vlerësimin e Gatishmërisë në Tranzicion, Plani i Veprimt të

Tranzicionit dhe vlerësimi i progresit me angazhimet e bashkëfinancimit të qeverisë siç është përshkruar në letrën e angazhimit të bashkangjitur në Konfirmimin e Grantit.



Gjatë vizitës së ekipit të Fondit Global sonë, u mundësua edhe një takim me Nën/Kryetaren e MKV-s Shqipëri dhe Sekretariatit në Znj. Manjola Kola lidhur me ecurinë e punës së Mekanizmit Koordinues Vendor dhe forcimit të rolit të tij në këtë fazë shumë të rëndësishme të fillimit të procesit të zbatimit të projektit të Fondit Global për Shqipërinë.



Një takim i rëndësishëm gjatë vizitës së ekipit të Fondit Global ishte ai i zhvilluar me Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve Z. Arben Çuko. Në takim u theksua rëndësia e projektit të Fondit Global për këtë institucion me fokus në: Rritjen e disponueshmërisë dhe qasjes së parandalimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për HIV, IST, TB, në shërbimet e kujdesit dhe trajtimit në ambientet e paraburgimit dhe ato të sistemit të burgjeve për të burgosurit stafit të ofrimit të shërbimit; Zvogëlimin e sjelljeve të rrezikut lidhur me HIV dhe

IST dhe reduktimi i diskriminimit midis të burgosurve dhe Stafit të shërbimit; Uljen e prevalencës për HIV dhe TB në IEVP-t dhe IVSHB-t; Trajnimin e Shërbimeve të Burgjeve dhe ofruesve të shërbimeve shëndetësore në parandalimin dhe trajtimin e HIV, IST dhe TB, në përputhje me programet dhe udhëzimet e parandalimit, kujdesit dhe trajtimit; Kryerjen e monitorimit rutinor të ofrimit të shërbimeve të HIV-it, IST-ve dhe TB-s në institucionet shëndetësore të burgjeve dhe kryerja e vizitave mbikëqyrëse të dokumentuara duke përdorur një format standard; Zbatimin e programeve gjithëpërfshirëse të reduktimit të rrezikut për të burgosurit HIV dhe HIV + dhe stafin e burgjeve, si edukimi shëndetësor dhe promovimi në të gjitha burgjet; Zhvillimi dhe zbatimi i një referimi efektiv për të siguruar lidhjen dhe ndjekjen e të burgosurve në ARV, medikamentet për TB apo programet e reduktimit të dëmit pas lirimit të tyre nga burgju.



Gjatë vizitës bazuar në axhendës e parapërgatitur u zhvillua një takim me Z.Blendi Dibra - Nën/Kryetar i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile duke e konsideruar takimin të vlefshëm dhe në përputhje me mandatin e tyre.

Në fund të vizitës u zhvillua një takim i kerkuar nga ana e Portfolio Manaxheres së Fondit Global për Shqipërinë Znj.Sandra Irbe, i cili u zhvillua ditën e premte, **4 Maj, ora 10:00**, në sallën e mbledhjeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me anëtarë të MKV-s Shqipëri dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe shëndetësore.



Në takimin informal u theksua se MKV-ja dhe aktorët e tjerë vendor të përfshirë në proces duhet të gjejnë mënyra për përshpejtimin e fillimit të implementimit të projektit. U theksuan dy hapa të menjëherëshëm që duhen ndër marrë:

- Përfudnimin e fazave të përzgjedhjes së Nën/Përfituesve si edhe miratimin e kontratave të Nën/Përfituesve sapo ato të jenë gati;

- Shtimin e amendamenteve në Manualin Operacional, që po vonon implementimin e programit

Gjithashtu në takim u vu theksi tek fakti se ende pa filluar procesi i zbatimit të projektit duhet menduar për mënyrat dhe mjetet që duhen përdorur pasi ka fonde të papërdorura që duhet menduar se si do të shpenzohen, me qëllim që në fund të vitit 2019 të jemi në gjendje të përthithim të gjithë financimin e parashikuar për Shqipërinë.

Për këtë qëllim nevojitet që:

- MKV-ja të marr në konsideratë dhe të miratojë ndryshimet në planet e zbatimit të granteve që janë propozuar nga Përfituesi Kryesorë bazuar në situatën e re të vonësave në fillimin e zbatimit të tij. Njëkohësisht nevojitet edhe fillimi i praktikave për përgatitjen e Kërkesës për Fonde, pasi pa e rifilluar këtë proces alokimi i këtyre fondeve për Shqipërinë do jetë i pamundur. Fondi Global do të autorizojë dy misione të asistencës teknike: një për vlerësimin e tranzicionit dhe tjetri për

përmirësimin e funksionimit të MKV-s Shqipëri. Përsa i përket tranzicionit, duhet të ngihet një grup pune me anëtarë të MKV-s të udhëhequr nga ekspertë ndërkombëtarë shumë të shquar dhe me përvojë. Ndërsa për mirëfunksionimin e MKV-s, Fondi Global do të shqyrtojë mënyra se si të përmirësohet funksionimi dhe roli i MKV-s në Shqipëri për ta bërë atë më të qëndrueshëm në skenën e koordinimit të shëndetit publik.

PLANIFIKIMI I QËNDRUESHMËRISË

Gjatë zbatimit të grantit duhet t'i kushtojmë vëmendje të veçantë qëndrueshmërisë së aktiviteteve që mbështeten me fonde grantesh si në zbatimin e aktiviteteve dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së tyre pas përfundimit të grantit.

Qëndrueshmëria do të përfshijë ndihmë ligjore, në hartimin e ndryshimeve në ligjet dhe rregulloret ekzistuese me ndihmën e Departamentit Ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Kryeministri dhe Ministri i Shëndetësisë i Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë priti në një takim ministror të Evropës Juglindore për përgjigjet e qëndrueshme ndaj HIV dhe TB në Shkup më 7 maj 2018.

Takimi Ministror i HIV-it për Evropën Juglindore, në Shkup më 7 maj 2018

Qëllimi i takimit ministror ishte diskutimi i progresit, sfidave dhe mundësive për arritjen e përgjigjeve të qëndrueshme ndaj HIV dhe TB në Evropën Juglindore. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e

Shqipërisë u përfaqësua në këtë takim nga Zv/Ministrja Znj. Mira Rakacolli.



Përfaqësuesit e shoqërisë civile patën mundësi të bashkohen me përfaqësuesit e nivelit të lartë nga të gjitha vendet e Europës Juglindore, donatorët dhe partnerët e zhvillimit global dhe të shkëmbejnë për progresin e bërë dhe çfarë mbetet të bëhet për të përbushur qëllimin e përfundimit të epidemive të AIDS dhe tuberkulozit në rajon si pjesë e Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Ministrat e Rajonit shprehen angazhimin në rritje të përgjigjeve kombëtare ndaj sëmundjeve, pasi mbështetja e jashtme financiare që përfshinte Fondin Global tashmë po orjentohet për të mbështetur vendet me barrë më të lartë botërore të sëmundjeve dhe me më pak kapacitete ekonomike për ti përballuar.

Ministrat u shprehën të angazhuar për shpërndarjen e fondeve vendase dhe për të siguruar qasje në trajtimin e HIV dhe Tuberkulozit për të gjithë, të udhëhequr nga strukturat qeverisëse që përfshijnë si

dhe se "prapa numrave janë njerëz për të cilët duhet të kujdesemi".

Gjatë qëndrimit dhe aktivitetit të zhvilluar në Shkup Zv/Ministrja Znj. Mira Rakacolli u takua me disa anëtarë të Bordit të Fondit Global, përfaqësues të vendit, donatorë dhe anëtarë të shoqërisë civile.

Gjithashtu gjatë takimit Ministerial u informua se Bordi i Fondit Global për Luftën kundër AIDS-it, Tuberkulozit dhe Malarisë, në mbledhjen e 39-të të Bordit, theksoi rëndësinë e forcimit të qëndrueshmërisë dhe mbështetjen e tranzicionit të suksesshëm ndaj financimit të brendshëm për të garantuar zgjidhje afatgjata dhe për të arritur një siguri dhe kujdes më të madh shëndetësor.

Fondi Global është i angazhuar për të qenë një partner i mirë në punën drejt qëndrueshmërisë, duke vepruar si një katalizator për investime shtesë, duke plotësuar boshllëqet afatshkurtra dhe duke adresuar pengesat për kalimin e suksesshëm drejt financimeve të brendshme. Ndërsa zhvendosja e financimit shpesh përfshin sfida, duke përfshirë edhe mënyrën e financimit efektiv të shoqërisë civile, tranzicioni rrit përgjegjësinë institucionale të vendit dhe është e nevojshme për t'i dhënë fund epidemive.



Një lajm i rëndësishëm për rajonin është se Bordi aprovoi një qasje ndaj vendeve me të ardhura të mesme dhe mbi mesatare në krizë ku rritja ekonomike është duke u frenuar dhe ku situata epidemiologjike dhe tejkalimi i mundësive për përballimin e ngarkesës kërcënon përparimin rajonal kundër HIV, TB dhe Malarisë.

shoqërinë civile dhe komunitetet e prekura së bashku me profesionistët shëndetësorë dhe partnerët teknikë. Megjithatë, disa konstatime konkrete nga organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit theksuan se situata është larg përbushjes


Publikohet Raporti i Mbledhjes së Menaxherëve të Programit Kombëtar të Tuberkulozit

Nga 31 maj-2 qershor 2017 Rajoni Evropian i OBSH-s zhvilloi Seminaret e Ëolfheze me Menaxherët e Programit të Tuberkulozit. Seminaret Ëolfheze 2017 synonin të forcojnë kontrollin e TB në Rajonin Evropian të OBSH-së, me theks në shkëmbimin e përvojave dhe diskutimin e zbatimit në progresin e Planit të Veprimit TB të Rajonit Evropian 2016-2020, Strategjisë globale të TB-së dhe planeve të veprimit të TB të vendeve evropiane. U theksua se në përgjithësi, ka pasur konsensus se zgjidhjet e shëndetit përmes procesit dixhital duhet të rriten, pasi ato kanë potencial për të mbështetur dhe përmirësuar trajtimin dhe parandalimin e TB dhe për të çuar në eliminimin e TB-s. Zbatimi i ndërhyrjeve shëndetësore dixhitale kërkon një vlerësim holistik dhe përgatitjen e sistemeve në mënyrë që të sigurohet përdorimi optimal i teknologjive dhe informacionit të grumbulluar.



Ndërhyrjet duhet të koordinohen dhe të përshtaten me nevojat e vendit përkatës. Prezantimi i ndërhyrjeve të reja shëndetësore dixhitale duhet të paraprihet nga një vlerësim i nevojave. Në Kazakistan psh, një vlerësim i tillë i nevojave ka treguar se ka një kërkesë të madhe për ndërhyrjet shëndetësore dixhitale; sisteme të ndryshme janë zbatuar në vend nga aktorë të ndryshëm, por këto aktualisht nuk kanë

sinkronizim dhe ndërlidhje midis tyre. Për të gjitha ndërhyrjet pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e sigurimit të konfidencialitetit; zgjidhjet shëndetësore dixhitale të përqendruara në kujdesin ndaj njerëzve duhet të jenë plotësuese për menaxhimin tradicional të rasteve. Pjesëmarrësit theksuan nevojën për një sistem i cili siguron që teknologjitë dixhitale të shëndetit të mbahen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme. Edhe pse përvoja e ndërhyrjeve shëndetësore dixhitale po rritet, u shpreh një nevojë e fortë për më shumë të dhëna të marra në grupe të ndryshme kushtesh, mjedisesh dhe midis grupeve të ndryshme të pacientëve.



Konkluzionet e Raportit dhe hapat e mëtejshëm

Pamja e përparimit dhe e sfidave është e paqartë dhe e ndryshme. Nga njëra anë, vendet kanë bërë progres në përputhje me udhëzimet strategjike të përcaktuara në TB-APP, për shembull në fushat e e-shëndetësisë, përfshirjes së shoqërisë civile dhe bashkëpunimit ndër-sektorial dhe partneritetit.

Përveç kësaj, kapaciteti kombëtar për diagnozë më të saktë dhe me kohë është përmirësuar në shumë vende të Rajonit, ndërkohë që normat e njoftimit për humbje në vazhdim dhe TB janë përmirësuar përgjithësisht.

Nga ana tjetër, vazhdojnë të mbeten si sfida të mëdha, si për shembull shkalla e suksesit të ulët të trajtimit, si për tuberkulozin, ashtu edhe për më të rëndësishmit, për pacientët me MDR-TB dhe bashkëinfeksion TB / HIV.

Këto sfida të vazhdueshme themelore u shfaqën gjithashtu në diskutimin e zhvillimit të planit kombëtar të veprimit. Për shembull:

Çështjet e qeverisjes: PKTB-s nuk janë gjithmonë të autorizuar plotësisht dhe të mandatuar për të zbatuar planet e tyre kombëtare të veprimit të tuberkulozit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për aspekte ndërsektoriale, siç janë fushat e përgjegjësisë që përputhen me ministritë e tjera (p.sh. drejtësia, arsimit dhe financat).

Sfidat buxhetore: Në shumë vende të Rajonit Evropian, mbështetja e Fondit Global ka shënuar rënie të ngadaltë, me qëllim rritjen e përgjegjësisë vendore / kombëtare të vendeve dhe kontributeve të tyre (bashkë). Sidoqoftë, disa nga vendet e prekura nuk janë ende në pozitë për të përballuar këtë barrë shtesë financiare pasi nuk kanë mekanizma të përshtatshëm dhe financiarë të financimit - për shembull, në përgjigje të natyrës ndërsektoriale të disa shpenzimeve.

Për më shumë informacion na vizitoni

në faqen tonë: <http://ccm-albania.al>

Mekanizmi Koordinues Vendor (MKV) është organi kombëtar bashkërendues i krijuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë, me pjesëmarrjen e të gjithë partnerëve strategjikë dhe të palëve të interesuara.



Duke pasur parasysh konkluzionet e tryezës, janë identifikuar disa hapa të mëtejshëm:

➤ Vazhdimi i asistencës teknike për vendet në përputhje me TB-APP; duhet të sigurohet mbështetje më e madhe për qëndrueshmërinë financiare (në lidhje me financimin e shëndetësisë, prokurimin e ilaçeve, qeverisjen etj.).

Kjo duhet të arrihet në bashkëpunim me partnerët dhe ndërsektorialisht brenda OBSH-së, duke përdorur burimet dhe ndarjet e ekipeve të tjera.

Vazhdimi i azhurnimit të rregullt dhe të statusit të përshtatjes dhe zbatimit të planit strategjik kombëtar, duke përdorur platforma të ndryshme (p.sh. iniciativat për të cilat OBSH / Evropa shërben si sekretariatat përkatës, si Komiteti Rajonal i Gjellbër, Iniciativa Evropiane për Hulumtimin e Tuberkulozit, Iniciativa dhe Komiteti Rajonal i Bashkëpunimit për Parandalimin dhe Kujdesin e TB) dhe të ngjarjeve relevante (si tryezat rajonale dhe konsultimet).

➤ Mbajtja e vendeve të informuara për udhëzime të reja dhe të përditësuara rajonale dhe globale që mund t'i ndihmojnë të përtërijnë dhe të bëjnë përparime të mëtejshme. Iniciativat e tilla përfshijnë diagnozën e shpejtë, ilaçet e reja, modelin e kujdesit të përqëndruar tek njerëzit, regjimet më të shkurtra, mjete të reja dhe shembuj të praktikave të mira në të gjitha ato që u përmendën më lart dhe, gjithashtu, në qasjet ndërsektoriale për të adresuar sfidat.

Lajme dhe informacione mbi grupet e punës të Ëolfheze dhe aktivitete të tjera nga Grupi i Punës Ëolfheze mbi Përcaktuesit Shoqëror të TB dhe TB-së rezistente ndaj ilaçeve u mbyll pas hartimit të përcaktuesve socialë dhe faktorëve të rrezikut për tuberkulozin në sistemet kombëtare të mbikëqyrjes në Evropë. Studimi zbuloi se informacioni mbi punësimin, mungesën e strehimit, diabetin dhe përdorimin e alkoolit grumbullohet në shumicën e sistemeve kombëtare të mbikëqyrjes së TB, por standardizimi i përkufizimeve epidemiologjike të rasteve duhet të miratohet. Grupi Punues i ECDC për Përcaktuesit Shoqëror dhe Faktorët e Rrezikut për TB duhet ta kryej këtë.



TB Action Plan 2016–2020; country implementation progress; focus on TB in mobile populations including migrants



Organizatrat ofruan përditësime mbi projektet dhe iniciativat e mëposhtme:

➤ Projekti i TB-së rajonale dhe forcimi i sistemit shëndetësor (TB-REP) (ËHO / Europe)

➤ Iniciativa Evropiane e Laboratorit të Tuberkulozit (ELI) (ËHO / Europe)

➤ Iniciativa Evropiane e Kërkimit (ERI) (ËHO / Europe)

➤ Udhëzime për diagnostikimin, trajtimin, kujdesin dhe parandalimin e tuberkulozit në mjediset e burgjeve (ECDC)

➤ Projekti E-DETECT TB (KNCV, Angli i Shëndetit Publik)

➤ Mjetet e vlerësimit të etikës dhe kurrikulën e trajnimit (Rutgers Global TB Institute, Neë Jersey Medical School, SHBA)

Grupet e reja të punës Ëolfheze

➤ U ra dakord që termat e referencës do të zhvillohen për pesë tema. Temat e zgjedhura janë:

➤ Drogat e reja dhe monitorimi dhe menaxhimi i sigurisë së barnave të TB (aDSM) (vazhdim i grupit të mëparshëm të punës)

➤ Aktivitetet bashkëpunuese TB / HIV (vazhdimi i grupit të mëparshëm të punës)

➤ Cilësia e kujdesit të përqendruar tek njerëzit

➤ Shëndeti digjital

➤ Migrantët dhe shkëmbimi i informacionit ndërkufitar të TB.



Ekspozitë Fotografike e pacientëve me TB gjatë Ëolfheze Ëorkshops e organizuar nga AFEË Kazakhstan.



BULETINI INFORMATIV

Mekanizmi Koordinues për Vendin Shqipëri

Adresa: Instituti i Shëndetit Publik,

Rr. Aleksandër Moisiu, Nr. 80
Tiranë, 1017, Shqipëri

Mekanizmi Koordinues i Vendit (MKV) është organi kombëtar bashkërendues i krijuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë, me pjesëmarrjen e të gjithë partnerëve strategjikë dhe të palëve të interesuara. MKV-ja ka në përbërjen e tij përfaqësues të institucioneve qeverisëse, OJQ-ve dhe grupimi i personave që jetojnë me HIV/AIDS, duke siguruar kështu zërin e shoqërisë civile në vendim-marrje.

Mekanizmi Koordinues i Vendit (MKV) të Republikës së Shqipërisë, është përgjegjës për koordinimin e procesit të aplikimit për financim nëpërmjet një procesi transparent e të dokumentuar, që angazhon një masë të gjërë të përfaqësuesve të grupeve të interesit dhe që përfshin anëtarët dhe jo anëtarët të MKV-s – në rishikimin, vlerësimin dhe hartimin e aktiviteteve që do të përfshihen në aplikim.

Ndonëse MKV u krijua për të bërë të mundur paraqitjen e kërkesës për fonde në Fondin Global për Luftën kundër HIV/AIDS dhe TB-it, funksionet e tij janë më të gjera se ato të programit të mbështetur nga Fondi Global.

Për më shumë informacion, ju lutem vizitoni faqen tonë:
<http://ccm-albania.al>